



Republika e Kosovës – Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Financave – Ministarstvo za Finansije – Ministry of Finance
Administrata Tatimore e Kosovës – Poreska Administraciia Kosovo – Tax Administration of Kosovo



Datë: 01.11.2018

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil dhe Rregulloren Nr.21/2012 për Avancimin në Karrierë të Nëpunësve Civil Administrata Tatimore e Kosovës shpall:

KONKURS I BRENDSHËM(AVANCIM)

Titulli i pozitës: Udhëheqës i Divizionit për Deklarim, Pagesa dhe Llogari (1 pozitë)

Nr. i referencës së pozitës së punës: BF/830/JP00035076

Përgjegjësi mbikqyrëse: Po

Shtylla funksionale: Programe dhe Procedura

I raporton: Drejtorit të Dep. të Shërbimit dhe Edukimit të Tatimpaguesve

Pozita: Pozitë e karrierës

Orari i plotë i punës: Po

Koeficienti: 9.5 plus shtesa e aplikueshme

Vendi i punës: Drejtoria e Përgjithshme-Prishtinë

Qëllimi i vendit të punës:

Divizioni i për Deklarim, Pagesa dhe Llogari është i themeluar në kuadër të Departamentit të Shërbimit dhe Edukimit të Tatimpaguesve me qëllim të ofrimit të shërbimeve për tatimpagues dhe ngritjes së nivelit të vetëdijes së tatimpaguesve për përmbushjen e detyrimeve në mënyrë vullnetare.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave lidhur me Sistemin Elektronik EDI,
- Mbikëqyrje e adresës edi@atk-ks.org dhe kthim i përgjegjësive për pyetjet lidhur me EDI,
- Rregullimi i gjendjes së tatimpaguesit aty ku të dhënat nuk janë proceduar në sistem,
- Mirëmbajtja e UEB faqes së ATK-se dhe të sigurohemi se është efektive dhe funksionale për informimin e tatimpaguesve si nga ana përmbajtësore e të dhënave dhe në aspektin teknik të sigurimit të shpejtësisë dhe eficiencës në ofrimin e shërbimit ndaj tatimpaguesve, etj
- Krijimi i lidhjeve të përputhjes së informative, lidhje me bazën e të dhënave (SIGTASIN) lidhje me raportimin,
- Dizajnojnë formularët e rinj tatimor dhe modifikojnë aktualet sipas kërkesës së Administratës Tatimore,
- Ndërlidhje me Teknologjinë Informative /procedimin e të dhënave/për t'u siguruar se formularët tatimor janë kompatibil me sistemet e Administratës Tatimore dhe se vështirësitë e tatimpaguesve mbi kompletimin e atij formulari janë identifikuar dhe janë rregulluar,
- Dizajnojnë Broshura, Fletëpalosje, Postare etj, sipas kërkesës së Administratës Tatimore,
- Detyra tjera që i ngarkohen nga mbikëqyrësi.



Kërkesat/Kualifikimet Profesionale:

Që të kryej këtë punë me sukses, një individ duhet të ketë:

- Diplomë Universitare drejtimi juridik, ekonomik apo biznesi,
- Minimum 5 vite përvojë pune profesionale;
- Njohuri të mirë të procedurave dhe proceseve që aplikohen në Administratën Tatimore të Kosovës;
- Aftësi komunikuese, negociuese dhe bindese ne menaxhim;
- Shkathtësi në caktim të objektivave, planifikim të punës dhe analizë;
- Shkathtësi në udhëheqje dhe organizim të ekipit, , aftësi për të menaxhuar një ekip ose grup punues;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve

Paraqitja e kërkesave:

Aplikacionet mund të merren në Drejtorinë e Përgjithshme të Administratës Tatimore të Kosovës, e cila gjendet në adresën: Këndi i rrugëve "Bill Klinton" dhe "Dëshmorët e Kombit" p.n. në Prishtinë ose në web-faqen e Administratës Tatimore të Kosovës: www.atk-ks.org tek rubrika e punësimit.

Aplikacionet e plotësuara së bashku me kopje të dëshmive të kërkuara sipas Shpalljes për rekrutim dorëzohen në Drejtorinë e Përgjithshme të ATK-së- në Prishtinë ne Zyrën e Burimeve Njerëzore.

Aplikacionit duhet bashkëngjitur kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme, që kërkohen për këtë vend të punës, për të cilin konkurroni.

Konkursi është i hapur 8 ditë nga dita e publikimit nga data 01.11.2018 deri më 08.11.2018.

Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha Komunitetet në Kosovë.

"Komunitet jo- shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional ne organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet ne nenin 11, paragrafin 3 te Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil te Republikës se Kosovës".

Aplikacionet e derguara pas dates se fundit nuk do te pranohen. Aplikacionet e pakompletuara do te refuzohen. Per informata shtesë mund te kontaktoni ne numrin e tel. 038/200 34 706 .

